



VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 23 nëntor 2011

Numri i lëndës 2011-26

Z. Njazi Asllani

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar më 15 shtator 2011.

II. THE FACTS

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve në dispozicion të Paneli, mund të përmbliidhen si në vijim. Një përshkrim më të hollësishëm i ngjarjes është i dhënë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 17 dhjetor 2010 (numri i lëndës: KI 08/09)

Parathënie

3. Më 27 shkurt 1990, drejtorja e përkohshme e ndërmarrjes shoqërore IMK-së (fabrikë e gypave të çelikut) në Ferizaj kishte ndërprerë kontratat e punës së parashtruesit të ankesës dhe të 571 punonjësve të tjerë për shkak se punonjësit e lartpërmendur kishin munguar nga puna për pesë ditë rresht. Pasta, punonjësit ishin paraqitur në punë çdo ditë deri në datën 5 maj 1990, mirëpo ata nuk ishin lejuar të hyjnë brenda në objekt. Nuk ishte shqiptuar ndonjë masë ndëshkuese para largimit nga puna.
4. Punonjësit kanë parashtruar një ankesë të përbashkët më 8 mars 1990. Ata nuk kanë pranuar asnjë përgjigje rreth kundërshtimit të tyre kundër largimit të tyre nga puna.

Procedurat gjyqësore lidhur me largimin nga puna

5. Më 2001 punëtorit kishin parashtruar një ankesë në Gjykatën Komunale të Ferizajt në lidhje me largimin e tyre nga puna dhe humbjen e pagave.
6. Më 11 janar 2002 Gjykata Komunale kishte vendosur se aktvendimi për t'i prishur kontratat e punës ishte i paligjshme dhe se të gjithë punonjësit që ishin paraqitur në punë deri më datën 1 maj të vitit 2001 duhet të riktheheshin në pozitën e mëparshme të punës dhe duhet t'i gëzonin të gjitha të drejtat e tyre që dalin nga kontratat e tyre fillestare me IMK-në nga 19 shkurti 1990 deri më 1 maj 2001.
7. Kompania e akuzuar kishte mundësi që të parashtronte ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës brenda tetë (8) ditësh nga data e dorëzimit të kopjes së vendimit. IMK-ja nuk e shfrytëzoi këtë mjet ligjor. Ky vendim ishte bërë i plotfuqishëm (*res juridica*) më 11 mars 2002.

Përmbartimi i vendimit të plotfuqishëm

8. Pasi IMK-ja nuk i respektoj detyrimet e veta rreth zbatimit të vendimit të plotfuqishëm, punonjësit kanë kërkuar një urdhër për përmbartim nga Gjykata e Qarkut e Ferizajt.
9. Më 22 dhjetor 2005 Gjykata e Qarkut kishte urdhëruar përmbartimin e vendimit të mëhershëm, d.m.th. pagesën e pagave të papaguara, dhe pengimin e privatizimit të IMK-së nga ana e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). Shuma e përgjithshme e pagave që duhej të paguhej arriti shumën 25.649.250 euro, me një kamatë vjetore prej 3% duke filluar nga data 13 mars 2002.
10. Më 16 janar 2006, një gjykatës i vetëm në Gjykatën e Qarkut, sipas detyrës zyrtare, kishte shfuqizuar pengimin e privatizimit të IMK-së. Ky vendim më vonë ishte vërtetuar nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës.
11. Pagesat nuk ishin kryer për shkak të përpjekjeve të vazhdueshme nga ana e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM) për të penguar përmbartimin e vendimit dhe për ta privatizuar IMK-në.

Procedurat para Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme

12. Më 2 gusht 2006, AKM-ja kishte parashtruar një ankesë tek Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme (DhVGjS) duke argumentuar se ishte e domosdoshme që të bëhej sqarimi i interpretimit të ligjit në rastet e ngjashme.
13. Më 9 gusht 2006, DhVGjS kishte hedhur poshtë ankesën, pasi e kishte cilësuar ankesën një përpjekje për tu ankuar kundër vendimit të plotfuqishëm të marrë në vitin 2002, i cili nuk mund të lejohej për arsye të sigurisë ligjore (*res judicata*).

Ngrirja e asetëve të IMK-së

14. Më 11 dhjetor 2006, Gjykata Komunale e Ferizajt kishte ngrirë asetet financiare të IMK-së, duke e detyruar AKM-në që t'iu paguaj punonjësve shumën prej 25.649.250 euro nga asetet e IMK-së. Ky vendim më vonë ishte shfuqizuar nga Gjykata Supreme, mirëpo pas rishqyrtimit të rastit Gjykata Komunale prapë i kishte ngrirë asetet më 23 tetor 2007. Ky vendim ishte vërtetuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës më 17 dhjetor 2007.

Procedura e privatizimit

15. Më 13 dhjetor 2006, AKM-ja kishte lëshuar një komunikatë për shtyp, duke deklaruar se e vetmja ofertë për privatizimin e IMK-së në rrethin e dytë të ofertimit ishte 3.657.000 euro.
16. Më 17 dhjetor 2007, DhVGjS kishte hedhur poshtë kërkesën për të penguar shitjen e kompanisë, mirëpo kishte konstatuar se ankesa e bazuar lidhur me pagat e papaguara, siç thuhet në vendimin e plotfuqishëm të vitit 2002, ekzistonte ende. Ankesa kundër vendimit të DhVGjS ishte hedhur poshtë më 8 shkurt 2008.
17. Në ndërkohë, IMK-ja ishte privatizuar tërësisht më 21 nëntor 2007 për 3.200.000 euro. Përpjekjet për të shfuqizuar privatizimin e IMK-së ishin të pasuksesshme.

Procedurat e likuidimit

18. Më 18 dhjetor 2007, AKM-ja e kishte shpallur IMK-në në likuidim. Kërkesa kreditore e punëtorëve ishte paraqitur në Komisionin për likuidime. Sipas njohurive të Panelit, këto procedura janë ende të pazgjidhura.
19. Më 6 tetor 2008, Gjykata Komunale e Ferizajt, sipas detyrës zyrtare, kishte pezulluar ekzekutimin e vendimit të formë së prerë të vitit 2002, pasi ishte njoftuar nga ana e AKM-së se IMK-ja është vënë në likuidim. Ky vendim i ishte dërguar punëtorëve vetëm një vit në vonë.

Procedurat para Gjykatës Kushtetuese

20. Më 18 dhjetor 2010, Gjykata Kushtetuese konstatoj se ishin shkelur të drejtat e punëtorëve, atëherë kur vendimi i formës së prerë (*res judicata*) i vitit 2002 për të paguar pagat e tyre kishte mbetur i pa ekzekutuar 8 vite pas marrjes së vendimit.

21. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 159.2 "interesat në pronësi shoqërore në pronat dhe ndërmarrjet në Kosovë janë pronë e Republikës së Kosovës". Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se kjo dispozitë duhet të kuptohet në atë mënyrë se aty ishte qeveria e Kosovës ajo e cila ishte përgjegjëse për të gjitha detyrimet e këtyre ndërmarrjeve, përfshirë kërkesën e punëtorëve për paga.
22. Gjykata Kushtetuese ka urdhëruar që vendimi i plotfuqishëm i vitit 2002 duhet të ekzekutohet nga qeveria dhe nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasuese ligjore e AKM-së, e cila duhet të njoftoj Gjykatën Kushtetuese rreth masave të ndërmarra për zbatimin e vendimit brenda gjashtë muajve.
23. Paneli nuk ka informata të tjera rreth këtyre procedurave.

Kontaktet me EULEX-in

24. Më 13 shkurt 2009, një kërkesë për përmbarimin e vendimit të datës 11 janar 2002 ishte parashtruar tek Komponenti i Drejtësisë së EULEX-it.
25. Më 10 prill 2009, një gjykatës i EULEX-it kishte njoftuar Sindikatën e punëtorëve se gjykatësit e EULEX-it nuk ishin kompetent që të bëjë përmbarimin e vendimeve të gjykatave të Kosovës. Sindikata ishte udhëzuar që të parashtronte një urdhër për përmbarim tek Gjykata Komunale e Ferizajt.
26. Në nëntor 2009, parashtruesi i ankesës kishte parashtruar një kërkesë tek një prokuror i EULEX-it në Prishtinë për të hetuar rastin. Ai ishte njoftuar se rasti ishte bartur tek Gjykata e Qarkut të Prishtinës. Ai nuk kishte marrë asnjë përgjigje tjetër nga prokurori i EULEX-it, dhe sipas tij zyrtarët e EULEX-it që punojnë në Gjykatën e Qarkut nuk kanë njohuri rreth kësaj çështjes.
27. Më 17 qershor 2010, parashtruesi i ankesës i kishte shkruar Komponentit të Drejtësisë së EULEX-it se ende nuk kishte pasur lëvizje përpara sa i përket përmbarimit të vendimit dhe kishte kërkuar që EULEX-i ta përdorte autoritetin e vet që të zbatonte vendimin. Sipas parashtruesit të ankesës, asnjë përgjigje nuk ishte pranuar nga Komponenti i Drejtësisë.

III. ANKESAT

28. Parashtruesi i ankesës pretendon se EULEX-i nuk ka bërë asgjë për të zbatuar vendimin përfundimtar të Gjykatës Komunale të Ferizajt, të marrë në janar të vitit 2002.

IV. LIGJI

29. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së vet të Punës.
30. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtës, polici dhe dogana, siç përcaktohet në Rregullën 25, paragrafi 1 i Rregullores së vet të Punës.
31. Sipas Rregullës së përmendur më lart, bazuar në konceptin e llogaridhënies në PLANIN OPERATIV të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat ligjore të gjykatave të Kosovës.
32. Paneli vëren se parashtruesi i ankesës në fakt kërkon që Paneli ta konstatoj shkeljen, pasi EULEX-i nuk ka ndërmarrë ndonjë masë në mënyrë që të sigurojë përmbartimin e një vendimit të marrë nga Gjykata Komunale e Ferizajt në vitin 2002.
33. Mandati i EULEX-it nuk e autorizon atë që t'i zbatoj vendimet e gjykatave të Kosovës, prandaj çështja e ngritur nga parashtruesi i ankesës nuk bie në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë.
34. Prandaj, kjo çështje nuk bie në kuadër të mandatit të Panelit, siç përcaktohet në Rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe të PLANIT OPERATIV të EULEX-it në Kosovë.
35. Sidoqoftë, Paneli thekson se Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar në vendimin e saj të datës 18 dhjetor 2010 se përmbartimi i një vendimi i cili merret nga ndonjë gjykatë duhet të cilësohet si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar sipas ligjit (shih, me ndryshimet nevojshme, KEDNj, *Hornsby kundër Greqisë*, vendim i datës 19 mars 1997, Raportet 1997-II, fq. 510, paragrafi 40). Më tutje, konstaton se ish-punëtorët e kompanisë nuk duhej që të pengoheshin të përfitonin nga ky vendim, vendim i cili ishte i formës *res juridica*, e që ishte marrë në të mirë të tyre.
36. Më tutje konstaton se vendimi i prerë detyruës gjyqësor në të mirë të parashtruesit të ankesës duhet të përmbartohet nga autoritetet kompetente, në veçanti nga qeveria e Kosovës dhe nga Agjencia e Privatizimit të Kosovës, si pasardhëse ligjore e AKM-së. Në lidhje më këtë, Paneli mund që vetëm të ritheksoj se përgjegjësia për marrjen e masave në mënyrë që të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese tani bie mbi autoritetet e Kosovës. Mbetet që ata të shqyrtojnë se çfarë masa, qoftë legjislative apo administrative, duhet të ndërmerren, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i vendimit, dhe të shqyrtohet fushëveprimi, afati dhe rendi i zbatimit të këtyre masave.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar këtë ankesë,

gjen se ankesa është e pabazuar sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës së vet, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit